




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER DRITAN J. GJANA
ADRESA NR.7, NIKOLLA JORGA,
NR.1, NR.2, NR.1
TEL: 0695813188



PROKURË E POSAÇME

Nr. repertori: 5316

Nr. koleksioni: 1642

Kamez më 13/12/2022

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022053160181975124



PROKURË E POSAÇME

Sot, më datë 13.12.2022, para meje Noter DRITAN J. GJANA, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, Rr. NIKOLLA JORGA, NR.1, NR.2, u paraqit personalisht:

I PERFAQESUAR:

GIUSEPPE SORRENTINO, shtetas Italian, lindur në NOLA (NA) dhe banues në Itali, lindur më 22/04/1987, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Karte identiteti italiane nr. CA96311CU.

I cili me dëshirë të lirë, vullnet të plotë dhe të pa vesuar, kërkoi nga unë Noteri redaktimin e kësaj prokure të posaçme në bazë të neneve nr. 64, 70 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, neni 62, neni 99 i ligjit 110/2018 "Për Noterinë", si më poshtë vijon:

"Unë i përfaqësuar i mësipërm, Emëroj si përfaqësues të posaçëm **Klejvis Duro**, atësia Arjan, amësia Denada, shtetas Shqiptar, lindur në Tiranë dhe banues në adresën Endri Keko; Nd. 25; H. 2; Njësia Administrative Nr. 3; Njësia Bashkiake Nr. 3; 1005; Tiranë, i datëlindjes 05/08/1994, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037022119 dhe nr. personal J40805066O, i cili ka të drejtë dhe kompetencë për të vepruar, pa patur nevojë për asnjë lloj autorizimi tjetër, në emër dhe për llogarine time, të paraqitet dhe të më përfaqësojë pranë Qendrës Kombëtare Të Biznesit Tiranë fizikisht dhe/ose online, për të më përfaqësuar ne procedurën e regjistrimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar ku unë jam në cilësinë e administratorit. Në funksion të porosisë përfaqësuesi ka të drejtë që të bëjë të gjitha aplikimet dhe nënshkrimet e dokumentave fizikisht apo online.

Përfaqësuesi si më sipër ka të gjitha tagrat e nevojshme për të më përfaqësuar mua si administrator pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të kryer gjithë procedurën e regjistrimit të aktit të themelimit dhe statutit të Shoqërisë si dhe për të tërhequr aktet e regjistrimit. Përfaqësuesi ka të drejtë të më përfaqësojë përpara zyrave të Tatim Taksave kompetente, për të depozituar dhe tërhequr dokumenta, për të tërhequr libra të TVSH-së, Zyra e punës, Zyrave të Sigurimeve Shoqërore dhe shëndetësore si dhe pranë cdo institucioni tjetër privat dhe publik të nevojshëm mbas regjistrimit të shoqërisë sipas interesave të shoqërisë.

Përfaqësuesi, përveç sa më sipër, ka të drejtë, tagër dhe kompetencë që në emër e për llogarinë time si administrator të veproj e të kryej çdo veprim tjetër të nevojshëm që nuk përmendet shprehimisht në këtë Prokurë të Posaçme dhe që mund të dalë nga rrethanat në të cilat kryhen këto veprime, kur një gjë e tillë vlerësohet si e nevojshme dhe në përputhje me interesin më të lartë.

Kjo prokurë e posaçme është e vlefshme nga momenti i nënshkrimit të saj dhe për një kohë të pacaktuar, deri në mbarimin e saj, me të drejtën e revokimit të saj në çdo kohë. I përfaqësuar deklaroi se: "Të gjitha veprimet e kryera nga përfaqësuesi im i posaçëm brenda tagrave të përcaktuara në këtë prokurë, në mbështetje të të drejtave që më njej legjislativi në fuqi në shtetin Shqiptar, do ti konsideroj të drejta e të mirëqena, sikur të ishin kryer prej vetë meje".

Prokura e Posaçme, u lexua nga unë Noteri me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të të përfaqësuarës, e cila e kuptoi përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e saj të lirë e të plotë, u njoh dhe i kuptoi efektet e saj juridike, e nënshkroi atë rregullisht përpara meje Noterit.

Giuseppe Sorrentino

Fq. 1



A2022053160181975124

Kjo Prokurë e Posaçme u hartua në gjuhën Shqipe prej meje Noterit në 3 (tre) kopje, me vlera të njëjta juridike, mbështetur në shprehjen e lirë e të plotë të vullnetit të të përfaqësuarit. Njëra kopje vendoset në arshivën noteriale, kopjet e tjerë për të përfaqësuarin.

Unë Noteri, verifikova identitetin e të përfaqësuarës nëpërmjet dokumentit të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë të neni 62, neni 99 i ligjit 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tij.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij akti, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

I PERFAQESUAR**GIUSEPPE SORRENTINO****NOTER
DRITAN J. GJANA**

Perktheu dhe lexoi ne gjuhen italiane
Aurela Kodra

